

SHENIMET SHPJEGUESE PER BILANCIN E AKTIVITETIT TE MBYLLUR TE VITIT 2019 PER SHOQERINE " KRETA-AL " SH.P.K

A) DISA SQARIME NE LIDHJE ME SHENIMET SHPJEGUESE PER BILANCIN E VITIT 2019

Shenimet shpjeguese qe shoqerojne bilancin per vitin ushtrimor 2019 jane hartuar konform kerkesave te SKK2. Keto japin detaje te hollesishme per zera te ndryshme te pasqyrave financiare dhe informacione reth zerave te cilat nuk kualifikohen per njohje ne pasqyra te ndryshme te ketij bilanci. Shenimet Shpjeguese japin: a) Informacione ne lidhje me bazen per pregatitjen e pasqyrave financiare si dhe politikat kontabel te perdorura; b) Informacion shpjegues te kerkuara nga SKK i cili nuk eshte paraqitur diku tjeter ne pasqyrat financiare, si dhe c) informacion i cili nuk eshte paraqitur ne pasqyrat financiare por eshte i nevojshem per tu kuptuar ndonje prej tyre.

Kjo njesi ekonomike paraqet shenimet shpjeguese si me poshte:

A) Deklarate qe pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me SKK.

B) Permbledhje e politikave kontabel te zbatuara.

C) Dhenia e shenimeve shpjeguese eshte e detyrueshme sipas SKK2. Shenimet shpjeguese ne kete bilanc japin Informacion sqarues per zerat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

D) Shenime te tjera shpjeguese.

Dhenia e informacioneve shpjeguese nga kjo njesi ekonomike per politikat kontabel.

Kjo njesi ekonomike me poshte paraqet nje informacion te shkurter lidhur me zbatimin e politikave kontabel:

a) Baza e matjes e perdorur ne pergatitjes e pasqyrave financiare.

b) Politika te tjera kontabel te perdorura per kuptimin e pasqyrave financiare.

Dhenia e Informacioneve ne lidhje me "Palet e lidhura" si dhe shpjegime per keto pale.

Njesia ekonomike " KRETA-AL" SH.P.K konsiderohet e lidhur me nje pale tjeter nese njera pale, ose kontrollon palen tjeter, ose ka nje ndikim te ndjeshem mbi palen tjeter. Per ti kuptuar me mire paqyrat financiare eshte e domosdoshme njohja nese njesia ekonomike eshte e varur dhe e ndikuar ne aktivitetin e saj nga pale te tjera. Kjo njesi ekonomike ne baze te dokumentacionit rezulton qe te mos kete asnje lidhje me kontrollin e paleve te treta apo ndikimin ndaj tyre. Bazuar ne kerkesat e SKK radha e dhenies te shpjegimeve eshte si me poshte;

a) Informacion i pergjithshem per politikat kontabel.

b) Shenimet te cilat shpjegojne zera te ndryshem te pasqyrave financiare.

c) Shenime te tjera shpjeguese.

B) INFORMACION I PERGJITHSHEM PER PASQYREN E PERFORMANCES TE HARTUAR NE MBYLLJE TE AKTIVITETIT EKONOMIK E FINANCIAR TE KRYER GJATE VITIT 2018.

Kuadri ligjor:

Ligji nr 9928 dt.29.04.2004 " Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Kuadri kontabel i aplikuar:

Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiper.(SKK 2;49)

Baza e pregatitjes te Pasqyrave Financiare:

Te drejtat dhe detyrimet e kostatuara (SKK 1,35)

Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F: (SKK1,37-69)

a)Njesia Ekonomike " KRETA-AL" SH.P.K mban ne llogarine e saj aktive,pasivet dhe ka raportuar te gjitha transaksionet.

b) Vijushmeria e veprimtarise ekonomike te njesise tone ekonomike eshte realizuar duke siguruar vazhdimesi dhe duke mos parashikuar nderprerje te saj ne te ardhmen.

c) Kompesim midis nje aktivi dhe nje pasivi eshte bere ne rastin kur personi juridik apo fizik paraqitet si klient dhe si furnitor njekohesisht vetem ne ato raste qe lejojne SKK.

d) Kuptueshmeria e Pasqyrave Financiare eshte realizuar plotesisht ne menyre qe informacioni i paraqitur te jete i standart, i kuptueshem dhe i qarte per perdorues qe kane njohuri te pergjithshme dhe te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.

e) Materialiteti është vlerësuar nga ana jone dhe ne baze të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zera materiale.

f) Besueshmëria Për hatimin e Pasqyrave Financiare është siguruar nepermjet punës të kujdesshme duke ruajtur vijimesinë me kusht që të gjitha zerat e bilancit të jenë material duke respektuar kërkesat e SKK. Ndërtimi i Pasqyrave Financiare me të gjithë elementet përberës të tyre kanë si baze zbatimin me korektesi të SKK.

Politikat Kontabel.

Pasqyrat Financiare të vitit 2019 janë ndërtuar sipas SKK-ve duke ju referuar nenit 4 të ligjit 9228 dt.29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Lista e llogarive të përdorur është ajo e publikuar nga "Keshilli kombëtar i kontabilitetit" e përshtatur për zbatimin sa më të plotë të SKK. Për mbajtjen e inventareve janë përcaktuar metodat e inventarizimit dhe mënyra e vlerësimit të tyre me qëllim që të jenë të plotësuar kërkesat e SKK 4.15 dhe konkretisht :

a) Për lëndet e para, materialet , mallrat dhe produktet është zbatuar metoda e inventarizimit të vazhdueshëm , ndërsa vlerësimi i tyre është bërë me koston mesatare të ponderuar

b) Për artikujt ushqimorë është përdorur inventarizimi i ndërmjetëm bazuar në metodën e vlerësimit me koston mesatare të ponderuar SKK 4.15.

Vlerësimi fillestar i AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është bërë me koston e plotë (SKK,5.11). Për prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga një hua, me koston huamarjes deri në përfshirjen e aktivitetit plotësisht në bilanc (plus interesat) kapitalizohen në koston e aktivitetit vetëm për periudhën e investimit deri në përfundim të tij (SKK 5.6). Vlerësimi i AAM është bërë me koston fillestare duke e paraqitur në bilanc me vlerën e mbetur, kosto fillestare minus amortizimi i akumuluar (SKK 5;21) Llogaritja e amortizimit për AAM është bërë duke u bazuar në ligjin nr.8438 dt.28.12.1998 i ndryshuar "Për Tatimin mbi të Ardhurat".Normat e amortizimit janë të njëjta me ato të pranuar nga sistemi fiskal në fuqi dhe konkretisht:

Për ndërtësat në mënyrë lineare mbi vlerën e mbetur deri në 5 % në vit.

Për kompjutera e sisteme informacioni deri 25 % e vlerës të mbetur.

Për të gjitha AAM të tjera deri në 20 % të vlerës të mbetur.Mbajtja e kontabilitetit është realizuar në mënyrë kompjuterike me programin ALPHA.

C) SHPJEGIME DHE KOMENTE PËR TREGUESIT E VENDOSUR NË BILANCIN E AKTIVITETIT EKONOMIK DHE FINANCIAR TË VITIT 2019.

Aktivet monetare në shumën 734705 lek përbejnë mjetet monetare që ndodhen në llogaritë bankare dhe arke. Gjendja në arke është në shumën 38941 lek kurse pjesa tjetër në shumën 695764 ndodhet në lek, në EURO dhe USD në llogaritë bankare.Gjendja reale e tyre jepet nga pasqyra perkatese që shoqëron shënimet shpjeguese, dhe që i bashkëngjitet këtij materiali. Grupi " Të drejtave të arketueshme" paraqiten në bilanc në shumën 48593741 lek përbejnë një burim të rendesishëm dhe të sigurte për vazhdimin normal të biznesit. Ky grup i bilancit përbehet nga zerat e më poshtëm:

1-"Të drejta të arketueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit"(llog.kliente) në shumën 12412395 lek. Analizuar sipas klienteve ky zë pasqyrohet nepermjet pasqyrës perkatese të inventarit të klienteve që i bashkëngjitet këtij materiali.

2- Zeri "Të tjera detyrime të arketueshme në shumën 36181346 lek përfaqëson tepricën kreditore të TVSH -se në shumën 5881461 lek të krihuar gjatë vitetve 2018-2019, si dhe detyrimin që ka Shoqëria "KRETA" Shpk në shumën 30299885 lek për kredinë e blerë nga shoqëria Kreta-Al në Tirana Bank.

3-Grupi i inventareve në bilanc paraqitet në shumën 22245208 lek dhe përben një burim të rendesishëm për zhvillimin normal të procesit të prodhimit dhe shitjes. Ky grup përbehet: 1-Zeri "Materiale" në shumën 10649702 lek. 2- Zeri "Produkte" në shumën 11595506 lek . Të gjitha zerat e grupit të inventareve në mënyrë analitike jepen nepermjet pasqyrave perkatese që shoqërojnë bilancin.

Për aktivet afagjata materiale të cilat në bilanc pasqyrohen në shumën 1556377 lek janë zbatuar kërkesat e SKK (5:90,91.92.93) të cilat janë të shprehura në pasqyrat që i bashkëngjiten këtij materiali nepermjet dy tabelave. Tabela e parë shpreh llojin dhe vlerën fillestare të aktivitetit në momentin e marrjes në kontabilitet, dhe tabela e dytë shpreh amortizimin e akumuluar dhe amortizimin e llogaritur për çdo grup të AAM. Në mënyrë analitike ndryshimet e AAGJ materiale jepen nepermjet pasqyrave perkatese që shoqërojnë bilancin. Për vitin ushtrimor shoqëria nuk ka llogaritur amortizim.

Për grupet e pasivitetit kemi shpjegimet si më poshtë:

Grupi i detyrimeve afatshkurter ne bilanc paraqitet ne shumen 61914074 lek dhe perben detyrimet e shoqerise ndaj:

(1) furnitoreve per blerjet e mallrave dhe sherbimeve te kryera gjate vitit ushtrimor qe ne fund te vitit ne bilanc pasqyrohen ne shumen 17569979 lek. I analizuar ky detyrim sipas furnitoreve jepet nepermjet pasqyres qe shoqeron bilancin.

(2) Kredia afatshkurter (overdraft) ne shumen 33227469 lek mare nga shoqeria gjate vitit 2019 per te siguruar zhvillimin norma te aktivitetit

(3) Punonjesve per pagat e pa paguara te cilat do te paguhen gjate vitit 2020 dhe ne bilanc paraqiten ne shumen 1285998 lek.

(4) Drejtorise Rajonale Tatimeve per detyrime tatimore shumen 500628 lek si me poshte : 1-Kontributin e sigurimeve shoqerore te muajit Dhjetor ne shumen 115405 lek , 2-Tatimi fitimi ne shumen 377123 lek sipas rezultatit te vitit ushtrimor , 3- Tatim ne burim ne shumen 8100 lek .

Grupi I detyrimeve afatgjata ne bilanc paraqitet ne shumen 3700924 lek dhe perben detyrimin e shoqerise ndaj "Tirana bank" per kredine afatgjate te mare gjate vitit 2019.

Kapitali i shoqerise " KRETA-AL " Shpk ne shumen 7515033 lek eshte percaktuar sakte dhe i pasqyruar drejt ne llogarite perkatese. Ky kapital eshte rezultat i aktivitetit te shoqerise ne viteve 2018-2019. I analizuar kapitali i shoqerise jepet nepermjet pasqyrave shoqeruese te bilancit.

D) DISA SHPJEGIME TE TJERA:

1) Te ardhurat e shoqerise jane te ardhurat e siguruara nga shitja e mallrave,produkteve dhe sherbimeve te cilat jane evidentuar ne llogarite perkatese. Per vitin ushtrimor 2019 struktura e te ardhurave eshte:

1- Te ardhura nga shitja e mallrave	38883	mije lek ose	51.4%
2- Te ardhura nga shitja e produkteve	36664	mije lek ose	48.5 %
3- Te ardhura te tjera	80	mije lek ose	1 %
TOTALI	75630		

Ne pasqyrat qe shoqerojne bilancin jepet nje informacion me i detajuar i burimit te te ardhurave dhe struktures te tyre.

2) Shpenzimet ne bilanc paraqiten sipas natyres se tyre , si materiale, paga, amortizim ,taksa dhe te tjera. Te gjitha shpenzimet jane te dokumentuara dhe pasqyruar ne llogarite perkatese.

3) Pasqyra e fluksit te parase eshte ndertuar sipas metodës indirekte dhe pasqyron levizjen e saj gjate vitit 2019..

4) Pasqyra e kapitalit jep nje informacion te kapitalit te shoqerise te krijuar ne vite si dhe rezultatin e vitit ushtrimor . Ne menyre analitike sipas zerave perkates dhe levizjes te tyre kapitali jepet ne pasqyren e kapitalit.

Hartuesi
Daniela Banushi



Administratori
Uljan Hoxhaj

